

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nenin 41 dhe nenin 42 paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 95 nga Ligjit i Procedurës së Përgjithëshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.124/15) dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 15 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe Kërkesën për paraqitjen e kërkesës për dhënie të interpretimi autentik të ligjit, nr ynë.ark.03-482/1 datë 31.01.2025, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.02-12 datë 29.01.2025, dhe në përputhje me Konkluzionin, ark.nr.02-365/4 datë 30.01.2025, Këshilli të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 3-të mbajtur më 29.01.2025, miratoi:

AKTVENDIM

1. Ndërpritet procedura lidhur me Njoftimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup PA1 nr.0204-74 datë 23.02.2024, me plotësime nga data 29.02.2024 dhe nga data 15.03.2024 dhe Vendimin e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) PA1 nr. 02-74, datë 21.03.2024 e cila lejon ndryshimin e strukturës së pronësisë të transmetuesit.

2. Ndërprerja e procedurës nga pika 1 e këtij Aktvendimi zgjat derisa organi kompetent - Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - të zgjidhë çështjen e mëparshme - për dhënien e interpretim autentik të nenit 42, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele - Anulim i vendimit që lejon zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë.

3. Ky aktvendim është përfundimtar, hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Arsyetim

Me rastin e Njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup PA1 nr.0204-74 datë 23.02.2024, me plotësime nga data 29.02.2024 dhe data 15.03.2024, Këshilli i Agjencisë në vazhdimin e parë të seancës së 9-të mbajtur më 20.03.2024, me propozim të Drejtorit të Agjencisë PA1 nr.0204-74, datë 08.03.2024, me ndryshimet e datës 19.03.2024, në përputhje me Konkluzionin ark.nr.02-1265/4 datë 20.03.2024, miratoi Vendim PA1 nr.02-74 datë 21.03.2024, e cila lejonte ndryshim në strukturën e pronësisë të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, përkatësisht: për tërheqjen e personit juridik Shoqërisë Aksionare TV Klan, me NVAJ J71413001L dhe adresë në rr."Aleksandër Moisiu"nr.97, Tiranë, Republika e Shqipërisë dhe pranimin e personit fizik Faton Shoshi, me NVAQ 1170784983, me dokument udhëtimi nr. P00936259 dhe adresë në rr.Sulejman Vokshi" nr. A1/L1, Prishtinë, Republika e Kosovës. Me vendimin në fjalë detyrohet që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, pas ndryshimit të bërë,

të dorëzojë në Agjenci gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RQRMV).

Pas miratimit të vendimit të lartpërmendur, Agjencia në disa raste, përmes Sistemit të Shpërndarjes së Internetit të RQRMV-së, ka kryer kontroll për të dhënat e gjendjes aktuale të transmetuesit - SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, dhe ka konstatuar se ndryshimi i miratuar në strukturën e pronësisë nuk është zbatuar, përkundër faktit se nga miratimi i Vendimit PA1 nr.20-74 datë 21.03.2024, që lejoi ndryshimin e strukturës së pronësisë, ka kaluar një periudhë më e gjatë kohore (10 muaj).

Fakti që dhe pas një periudhe të gjatë kohore (10 muaj), transmetuesi drejtuar Agjencisë nuk dorëzoi dokumentacion me të cilin do të mund të konstatoj se ndryshimi në strukturën e pronësisë është realizuar, duke treguar se transmetuesi nuk ka ndërmend të zbatojë vendimin në fjalë. Prandaj, janë shqyrtuar mundësitë për anulimin e vendimit me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë, siç parashihet në nenin 42 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Sipas nenit të cituar, Agjencia me vendim do anulon vendimin me të cilin lejon zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë nëse ky vendim është marrë në bazë të të dhënave të pasakta ose/ jo të plota për të cilat është përgjegjës transmetuesi ose të njëjtat janë marrë në rrugë mashtrimi, dhe kanë pasur ndikim vendimtar mbi marrjen e vendimit. Me vendimin nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia : - anulon vendimin me të cilin ka lejuar zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë, - përcakton se me ndryshime e propozuara të strukturës së pronësisë do të krijohet përqendrim i paligjshëm mediatik, respektivisht se e njëjta është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34,35 paragrafi (2) ose 38 të këtij Ligji dhe – urdhëron transmetuesin që në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë nga dita e pranimit të vendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, të harmonizojë strukturën e pronësisë me dispozitat e ligjit. Agjencia do të marrë vendim në pajtim me paragrafi (1) të këtij neni, pa u kufizuar në afatet e përcaktuara në nenin 41 të këtij Ligji Nëse transmetuesi nuk vepron në pajtim me vendimin e paragrafit (1) të këtij neni Agjencia do të marrë lejen për transmetim televiziv ose radio sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me këtë Ligj.

Prandaj, në nenin 42, paragrafi (1) të LSHMAAV nuk parasheh bazë për anulimin e vendimit që lejon ndryshimin e strukturës së pronësisë nëse transmetuesi nuk e zbaton ndryshimin, përkatësisht nuk e zbaton vendimin.

Në funksion të kësaj, janë shqyrtuar dhe arsyet për shpalljen e pavlefshme të vendimit, përkatësisht për anulimin e tij në përputhje me nenin 124 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative - LPPA (Shpallja e aktit administrativ të pavlefshëm), por megjithatë asnjë nga këto arsye nuk mund të përmendet si rast i mosekzekutimit nga pala (transmetuesi) i vendimit PA1 nr.02-74 datë 21.03.2024, i cili lejoi ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup.

Në lidhje me sa më sipër, është konstatuar nevoja për të kërkuar interpretim autentik të nenit 42, paragrafi (1) të LSHMAAV nga Kuvendi i RMV-së, përmes Qeverisë së RMV-së, në kuptimin: Nëse dokumentet e dotëzuara nga transmetuesi para gjashtë muajsh ose më shumë, në bazë të të cilave është marrë vendimi që lejon ndryshimin e strukturës së pronësisë të transmetuesit, i cili nuk e ka realizuar, mund të konsiderohet i saktë ose/ i plotë në kuptim të nenit 42 paragrafi (1) të LSHMAAV, ose të njëjtit me skadimin e periudhës prej gjashtë muash ose më shumë janë bërë të pasakta ose / të paplota, që është bazë për anulimin e vendimit të miratuar që lejon ndryshim të strukturës së pronësisë të transmetuesit? .

Synimi është që me marrjen e interpretimit autentik të ofrohet interpretimi i kontestimit të nenit 42 paragrafi (1) të LSHMAAV, i cili do të mund të zbatohet në raste të mundshme të ngjashme në të ardhmen.

Me atë rast, Drejtori i Agjencisë drejtuar Këshillit të Agjencia dorëzojë Propozim PA1 nr. 02-12 datë 29.01.2025, për ndërprerjen e procedurës derisa të zgjidhet çështja e mëparshme.

Agjencia me 31.01.2025, drejtuar Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ka paraqitur Kërkesë për paraqitjen e kërkesës për dhënien e interpretim autentik të ligjit (nr ynë.ark.03-482/1 datë 31.01.2025).

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nenin 41 dhe nenin 42, paragrafin (1) të LSHMAAV, neni 95 nga LPPA dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 15 të Rregullores së Punës së Agjencisë dhe Kërkesën për paraqitjen e kërkesës për interpretim autentik të ligjit, nr ynë.ark.03-482/1 datë 31.01.2025, duke vepruar sipas Propozimin PA1 nr.02-12 datë 29.01.2025, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-365/4 datë 30.01.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 3-të mbajtur më 29.01.2025, miratoi aktvendim, për ndërprerjen e procedurës sipas Njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup PA1 nr.0204-74 datë 23.02.2024 me plotësimet nga data 29.02.2024 dhe data 15.03.2024 dhe Vendimin e Këshillit të Agjencisë PA1 nr.02-74 datë 21.03.2024, që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë. Ndërprerja e procedurës nga pika 1 e këtij aktvendimi zgjat derisa organi kompetent - Kuvendi i RMV-së - të zgjidhë çështjen e mëparshme - duke dhënë interpretim autentik të nenit 42, paragrafi (1) të LSHMAAV- Anulimi i vendimit me të cilin lejohet zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Akvendim është përfundimtar, dhe kundër këtij aktvendimi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të tij.